

por provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfituar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde.

Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brënda lëndës/modulit duhet të bëhet sipas modelit të detajuar paraprakisht nga departamenti.

Pikët e fituara gjatë vitit i bëhen të njohura studentit para provimit.

Kur lënda përmban dy ose më shumë module, nota përfundimtare vendoset mbi bazën e mesatares së ponderuar.

Çdo departament përcakton edhe parakushtet (lëndët me kusht) për çdo lëndë. Detajime mbi to përcaktohen në rregulloret e njësive kryesore.

Studenti përfiton të drejtën për tu paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në planin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë rregullore si dhe në rregulloren e fakultetit.

Neni 46

Kontrolli i dijeve bëhet: me shkrim, me gojë ose i kombinuar.

Mënyrat, format dhe elementët e kontrollit të dijeve përcaktohen në rregulloret e brendshme të fakulteteve. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor.

Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.

Njësitë kryesore me rregulloret e tyre të brendshme, mund të krijojnë komisione për mbikqyrjen e procesit të provimeve, nëse e vlerësojnë një gjë të tillë.

Neni 47

Provimet

Studenti ka të drejtë të japë provim në katër sezone të rregullta të vitit akademik: sezonin e dimrit, pranverës, verës, dhe vjeshtës. Studentit të vitit të fundit të studimeve të ciklit të dytë, përveç 4 sezoneve të rregullta, i jepet edhe një sezon që paraprin sezonin e diplomës. Në këtë sezon studenti mund të japë 1 provim të ngelur ose 4 provime përmirësimi.

Statusi i studentëve (kalues ose përsëritës) përcaktohet me përfundimin e sezonit të vjeshtës.

Pas përfundimit të sezonit të vjeshtës dhe para fillimit të vitit akademik, sekretaritë mësimore hartojnë listat përfundimtare të studentëve që frekuentojnë vitin pasues dhe ia bëjnë të njohur zyrtarisht fakulteteve dhe departamenteve.